



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, më datë 05.05.2016 shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

I. ZYRTAR PËR TATIMIN NË PRONË

Drejtoria: Drejtoria e financave, ekonomisë dhe zhvillimit

Njësia – E tatimit në pronë

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: koeficienti aktual- 6

Numri i referencës së vendit të punës: 01Nr.111-12261 /16

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Është përgjegjës për kompletimin e saktë të dosjeve të të dhënave për objektet e pronës së pa luajtshme, shpërndarjen e faturave tatimore – letërkujtesat si dhe të vërejtjeve të fundit të tatimpaguesve – 20%
2. Viziton objektet e caktuara të pronave, regjistron pronarin dhe pronat si dhe plotëson të gjitha të dhënat në formularin e aprovuar, – 20%
3. Bënë shpërndarje e faturave tatimore, letër-kujtesat dhe vërejtjet tjera të tatimpaguesit të pronës (vërejtjet e fundit) brenda afatit të paraparë me ligj, – 15%
4. Bënë hulumtime dhe analiza rreth personave të cilëve iu ka adresuar fatura tatimore dhe vërejtjet tjera, duke marrë nënshkrimet e marrësit të faturave – vërejtjeve, hulumton pasuritë dhe informatat e tatimpaguesve si dhe mbanë evidencë të llogarive me prioritet që duhet të vjelen, – 15%
5. Shfrytëzon mundësitë e sistemit të tatimit në pronë, identifikon faturat e papaguara tatimore dhe llojin e aksionit që kërkohet sipas procedurave ligjore – 10%
6. Bashkërendon aktivitetet dhe koordinon punët me gjeometrin, kujdeset për mirëmbajtjen e shënimeve në regjistror, merret me ankesat e qytetarëve dhe mbanë përgjegjësi të plotë të regjistrimit të pronave, – 10%
7. Shpërndanë të tatimpaguesi vendimet e nxjerra sipas vendimit të bordit komunal të shqyrtimit të ankesave, – 5%
8. Kryen detyra tjera në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe. 5%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Diplomë universitare në ekonomi pa përvojë ose shkollë e lartë dhe së paku dy (2) vite përvojë pune.
- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar për mes arsimin universitar,
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës:
- Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit:
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, access):

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : pa afat të caktuar

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik, prej 05.05.2016 deri më 19.05.2016.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -**Zyra e pranimit**, kati përdhës dhe në web-faqen komunale .

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e Fakultetit të kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, vërtetimin e përvojës së punës, certifikata mbi trajnimet e kryera, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”. “Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

